



Prishtinë, 23 janar 2013
Kodi i ZRRE-së: V_501_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 12.1.20 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 24.12.2012 për shqyrtimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2013 – 2022”

në seancën e mbajtur me datë 23 janar 2013, nxori këtë:

VENDIM

I Aprovohet “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2013 – 2022”

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 24.12.2012 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2013 – 2022” të KOSTT SH.A. Dokumenti ka qenë në diskutim publik dhe ZRRE ka dhënë komentet e veta për të cilat janë bërë korrigjimet, sqarimet apo përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura. Pas përfshirjes së komenteve në dokument, ZRrE vlerëson se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara për aprovim dhe aprovon “Planin Zhvillimor të Transmisionit 2013 – 2022” me vërejtjen si më poshtë:

- **Paket Projekti - “UNAZA 400kV Gjakovë – Prizren – Ferizaj”:** edhe pse ky projekt parashihet diku pas afatit që përfshinë në dokument, ZRrE mendon se duhet pasur kujdes në iniciimin e këtij projekti, dhe kërkohet të studiohet në hollësi fizibiliteti i investimit të tij.
- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar